


TUBERKULOZI TEK FEMIJET



Kjo broshurë përmbledh pyetjet më të shpeshta që u drejtohen punonjësve të sektorit shëndetsor nga prindërit, mësuesit dhe nga të gjithë ata që dyshojnë se fëmija e tyre ka sëmundjen e tuberkulozit. Urojmë që përgjigjet, të formuluara tashmë me një gjuhë të thjeshtë të mund t'ju qartësojnë problemet që kanë të bëjnë me këtë sëmundje të cilën brezat e vjetër e kanë jetuar me ankth, frikë e largim nga jeta shoqërore.



Rritja kohët e fundit në Itali e rasteve të infektimit tuberkular mund të ndalohet vetëm duke vënë në jetë të gjitha **masat mbrojtëse diagnostikuese e kuruese që aktualisht vihen në dispozicion.**

Prandaj jemi përpjekur të përhapim keto njohuri, duke ditur që njohja e kësaj sëmundjeje dhe e problemeve që lidhen me të përbëjnë hapin e parë për ta luftuar atë.



Në shkollën e fëmijës tim po
bëjnë kërkime epidemiologjike
sepse është gjetur një rast
tuberkulozi...

Çfarë është tuberkulozi?

Tuberkulozi ose siç quhet
ndryshe TBC është një sëmundje
e cila shkaktohet nga bakteri
që quhet



**Mycobacterium
tuberculosis,**

Ky bakter mund të prekë
çdo pjesë të trupit, por zakonisht
përqëndrohet në mushkri.

KUJDES!!!

Vitet e fundit, edhe në Itali,
infeksioni tuberkular ka pësuar rritje
të ndjeshme në numër, rrjedhja e
kësaj sëmundje për fëmijët
reflekton gjendjen epidemiologjike
të të rriturit.

Kur infektohet ose sëmuret një fëmijë,
do të thotë se një i rritur është duke e
përhapur bakterin.

**Si mund të sëmuresh
nga tuberkulozi?**

Ngjitja bëhet nga personi në person nëpërmjet ajrit.
Kush është prekur nga tuberkulozi pulmonar (në mushkri) e që nuk është kuruar akoma ashtu siç duhet, mund të përhapë mikroorganizmat në ajrin që thithet nga personat që i rrinë afër nëpërmjet kollës, tështimave ose thjesht duke folur.



Rezikohen të infektohen personat që kanë kontakt direkt me të sëmurin, veçanërisht familjarët ose personat që i rrinë afër për shumë orë gjatë ditës në ambiente ku nuk qarkullon ajri.

Përhapja e sëmundjes ndodh kur i sëmuri është prekur nga nga një formë sëmundje që quhet **"e hapur"** (pjesa e sëmurë duhet të ketë lidhje me bronket dhe me ambjentin e jashtëm).

Fëmijët nën moshën 12 vjeç të sëmurë nga TBC rrallëherë e kanë sëmundjen ngjitesë sepse të çarat në mushkëri janë të vogla, nxjerrja e bakterit të tuberkulozit është e papërfillëshme dhe kolla ose nuk është e pranishme ose është me përmasa të vogla.

Shumë persona në botë preken nga kjo sëmundje, por vetëm pak (10%) sëmuren, sepse kur bakteret

arrijnë në mushkri, organizmi me sistemin e tij imunitar mobilizohet për ta mbajtur mikrobin nën kontroll dhe për të penguar rritjen e tij.

Çfarë është injekimi në lëkurë i Mantoux?

Është një test në lëkurë që tregon nëse ka patur apo jo infeksion tuberkular.

SI KRYHET?



Testi kryhet duke injektuar në lëkurë 5 njësi me elemente proteinash (PPD) të bakterit tuberkular në krah.

MOS E LANI DHE MOS E KRUANI LËKURËN !

KUR MATET?



Mbas 48-72 orësh lëkura rreth e qark skuqet dhe forcohet dhe në këtë moment mund të masim me një vizore të posaçme

Është mjeku ai që do të vendosë, në bazë të përhapjes së Mantoux, nëse është pozitiv apo negativ.

Çfarë është e nevojshme të bëhet nëse fëmija del pozitiv gjatë provës së Mantoux

Të bëhet një radiografi e krahërorit për të përcaktuar nëse sëmundja është në fazë “aktive” apo jo.


Nëse nuk ka dëmtime të mushkrisë, atëherë mund të flitet për TBC të fshehtë.

**Çfarë është infeksioni i fshehtë?
Quhet infeksion i fshehtë situata në të cilën rritja e bakterit bllokohet nga sistemi imunitar i organizmit ku tashmë është futur bakteri.**

Si paraqitet mantoux në infeksionin e fshehtë?

Mantoux është pozitive, por radiografia e krahërorit është negative.

Në disa raste, bakterit mbetet gjallë në trupin e njeriut për vite me radhë ose për gjithë jetën, dhe mund të veprojë në momentin kur sistemi imunitar i organizmit dobësohet.



Fëmijës tim vetëm mantoux i ka dalë positive; megjithatë i është kërkuar të bëjë një kurë që zgjat 9 muaj. Mos vallë është i sëmurë?

Jo!

Fëmija juaj ka vetëm një TBC të fshehtë, bakteret e tuberkolozit gjenden në gjendje joaktive në mushkëri, por në periudha stresi të fortë mund të riprodhohen dhe të aktivizojnë sëmundjen.

Ekziston një ilaç i cili quhet Isoniazide i cili është i aftë të bllokojë shumimin e baktereve dhe të mos lejojë që infeksioni të kthehet në sëmundje.

Ky ilaç (Isoniazide) është një antibiotik, si vepron?

Ilaçi bllokon shumimin e baktereve të tuberkolozit brenda munshkërive, nuk lejon që infeksioni të kthehet në sëmundje.

Mund të jetë i rezikshëm?

Zakonisht tolerohet nga organizmi i fëmijës, efekti kryesor i padëshirueshëm është çregullimi i transaminazave. Funkzioni i mëlçisë normalizohet kur ndërpritet ilaçi.

Fëmija të cilit vetëm mantoux i ka dalë pozitiv mund tua ngjisë sëmundjen të tjerëve?

Jo!

Sepse ka vetëm infeksion të fshehur e në këtë rast organizmi nuk nxjerr jashtë baktere.



Në klasën e fëmijës tim të gjithë fëmijëve u është bërë mantoux sepse një mësues është infektuar nga TBC. Edhe pse fëmijës tim mantoux i ka dalë negativ, më kanë këshilluar t'i filloj një terapi me një ilaç dhe duhet të përsëris testin mbas 2 muajsh. Pse?

Periudha e inkubacionit (që fillon nga momenti i ngjitjes së sëmundjes deri në momentin kur Mantoux del pozitiv) zgjat nga 2 deri në 12 javë. Kjo është arsyeja që mantoux del negativ 3 muajt e parë. Për këtë arsye, është e rëndësishme të përsëritet.

Ç'është sëmundja tuberkulare?

Kur sistemi imunitar i organizmit nuk arrin ta bllokojë rritjen e bakterit, ai shumohet brenda organizmit dhe shkakton sëmundjen.

Disa persona sëmuren menjëherë pas infektimit, të tjerë sëmuren më vonë kur sistemi imunitar i organizmit dobësohet për ndonjë arsye, duke patur në këtë rast sëmundjen aktive. Në këto raste radiografia nxjerr në pah një rezultat që është tipik për këtë sëmundje.

Jemi emigrantë në Itali. Kemi ardhur nga Amerika Jugore disa muaj më parë. Fëmija ynë 3 vjeç, është vaksinuar regullisht kundër TBC që kur ka lindur. Përse

atëherë kërkojnë që ne të
autorizojmë për t'i bërë sërish
mantoux fëmijës meqenëse ka
patur një rast tuberkulozi?
Vaksina nuk e mbron fëmijën?

Vaksina kundër tuberkulozit është
një vaksinë që përmban baktere
jo aktivë e jo të rezikshëm që
quhet BCG dhe që është e
sukseshme në 70% të rasteve. Kjo
vaksinë mund të parandalojë
forma të rënda meningiti, por jo
infeksionin. Në këtë rast nëse
fëmija është infektuar dhe del
pozitiv gjatë mantoux kjo do të
thotë se ka Tuberkoloz të fshehtë
dhe e mira është që të merret ilaçi
me emër Isoniazide

Vaksina që është bërë fill mbas lindjes mund të bëjë që ta lexojmë keq rezultatin e Mantoux?

Jo, sepse diametri i i shtrirjen së ilaçit të futur nën lëkurë është 1-2 milimetra.

CILAT JANË SINTOMAT E SËMUNDJES SË FËMIJËS?

KOLLË PËR MË SHUMË SE 2 JAVË

TEMPERATURË JO E LARTË POR E VAZHDUESHME

DJERSË NATËN

HUMBJE PESHE

SI MUND TË KUPTOSH NËSE JE SËMURË NGA TUBERKOLOZI APO JO?

SHENJA KLINIKE

Kollë, dobësim dhe djersitje natën

MANTOUX POZITIV

SHENJA RADIOLOGJIKE

ANALIZË E LËNGJEVE TË STOMAKUT

ANALIZË E LËNGJEVE QË DALIN JASHTË

GJATË KOLLËS


SI KUROHET SËMUNDJA NË FAZË AKTIVE?

**Bakteri i tuberkulozit mund të
ngordhet nga antibiotikët.**

Që kura të jetë sa më e
efektshme, duhet të merren 3 ose
4 antibiotikë për të paktën 6 muaj
pa ndërprerje.

**JA se cilët janë antibiotikët që
përdoren më
shpesh:**

**ISONIAZIDE
RIFAMPICINA
PIRAZINAMIDE**



Cila është arsyeja që merren tre
ose më shumë antibiotikë
njëherësh?

Për të qenë të sigurtë se të gjithë
bakteret janë ngordhur e që
asnjë bakter të mos shpëtojë,
është e nevojshme të përdoren
disa antibiotikë. Nëse përdoret
vetëm një antibiotik, ndonjë bakter
mund të shpëtojë dhe mund të fillojë
të shumohet sërish.

MOS HARRO TI JAPESH ILAÇET
FEMIJES TEND ÇDO DITE!

Nëse e ndërpritni kurimin përpara
afatit të caktuar ose harroni t'i
jepni ilaçet fëmijës tuaj, atëherë
kura nuk funksionon.

**FËMIJËT TUAJ DO TË SHËROHEN
NGA TUBEKULOZI VETËM NËSE DO
TË NDIQNI RIGOROZISHT
MJEKIMIN E CAKTUAR NGA
MJEKU**

**Bahkëpunuan për tekstin:
Dott. Giuseppina Veneruso
Ambulanza për fëmijët e adaptuar dhe të huaj.
Reparti për sëmundjet infektive
Klinika pediatrike I
Klinika spitalore universitare
Anna Meyer di Firenze**

Versione in lingua albanese
rivista per il GLNBI -SIP
da Shpresa XHEKA
(AOU Maggiore di Novara)